



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Indeksi i Klimës së Biznesit IFO në Kosovë

Tremujori i katërt i vitit 2023



Mars 2024

Indeksi i Klimës së Biznesit IFO në Kosovë

Indikator Matës i Tendencës në Biznes

Tremujori i katërt i vitit 2023



**ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE**

Mars 2024

Publikuar nga:
Oda Ekonomike e Kosovës

Bul. Nëna Terezë, Nr.20.
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës
Fix: +383 (0) 38 224 299

info@oek-kcc.org
www.oek-kcc.org

Autore:
Muela Ibrahim Hamdiu
Muela.ibrahimi@oek-kcc.org

Mbështetje teknike:
Shpresa Vokshi Jupolli

Oda Ekonomike e Kosovës falënderon ekipin anketues për kontributin e tyre në grumbullimin e të dhënave në 7 rajonet kryesore të Kosovës.

Prishtinë, 2024

Të nderuar miq dhe kolegë



Iniciativa për rifillimin e publikimit të raportit “Monitorimi i bizneseve në Kosovë” nga Oda Ekonomike e Kosovës, është një hap i rëndësishëm që siguron informacione të sakta për bizneset në Kosovë. Oda Ekonomike e Kosovës gjatë këtij studimi synon që përveç informimit të përceptimit të komunitetit të biznesit të trendëve të bizneseve të Kosovës, gjithashtu të promovoj vlerat e biznesit të Kosovës dhe të kontribuoj në përafrimin e tyre me vlerat Evropiane. Oda Ekonomike e Kosovës gjatë aktivitetit të saj ka

pasur për qëllim të rrisë nivelin gjeneral të ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje në vlerën e sipërmarrësisë që Kosova posedon. Në lidhje me këtë, rol të rëndësishëm në krijimin e vlerave të brendshme në Kosovë dhe vendosjen e tyre në tregjet nacionale dhe internacionale e ka komuniteti i biznesit i cili ndikon në ngritjen e mirëqenies së ekonomisë dhe shoqërisë në tërësi. Prandaj, për ngritjen e imazhit të shtetit tonë dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj drejt formave të ndryshme të partneritetit. Ky publikim para se gjithash do t’u shpërndahet të gjitha kompanive që kanë participuar në studim, të gjitha institucioneve shtetërore, komunitetit të biznesit, zyrave diplomatike, organizatave donatore dhe të gjitha grupeve të interesit të cilat në mënyrë direkte dhe indirekte influencohen nga promovimi i aktiviteteve të ekonomisë së Kosovës. Gjithashtu, ky studim do t’u shpërndahet atyre që kanë ndihmuar në ngritjen e imazhit të Kosovës dhe vlerave të tyre në Kosovë dhe jashtë vendit.

Me respekt
Lulzim Rafuna

Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	9
Hyrje	11
1. Metodologjia	13
2. Gjetjet Kryesore të Analizës	15
2.1. Gjetjet kryesore: Indeksi i Klimës së Biznesit në Kosovë	15
2.2. Gjetjet Kryesore: Indikatorit i Konfidencës së Biznesit.....	16
2.3. Gjetjet Kryesore: Vlerësimi i Gjendjes Aktuale nga Bizneset	17
2.4. Gjetjet Kryesore: Pritjet për Punësim për Tre (3) Muajt e Ardhshëm	19
2.5. Gjetjet Kryesore: Pritjet për Gjashtë (6) Muajt e Ardhshëm.....	21
2.6. Gjetjet Kryesore nga Perspektiva Sektoriale.....	23
3. Gjetjet Kryesore të Analizës së Sektorëve	25
3.1. Sektori i Prodhimit	25
3.2. Sektori i Shërbimeve	31
3.3. Sektori i Ndërtimit.....	34
3.4. Sektori i Tregtisë me Shumicë	39
3.5. Sektori i Tregtisë me Pakicë	43
4. Ndikimi i Liberalizimit të Vizave në Sektorin Privat të Kosovës	46
5. Barrierat e të bërit biznes në Kosovë	50
5.1. Masat për të adresuar barrierat e identifikuara.....	51
6. Konkluzione dhe Rekomandime	53
References.....	55

Lista e figurave

Figura 1: Indeksi i klimës së biznesit IFO në Kosovë	15
Figura 2: Indikatori i konfidences së biznesit	17
Figura 3: Vlerësimi i gjendjes aktuale nga bizneset	18
Figura 4: Vlerësimi i gjendjes aktuale: Balanca	18
Figura 5: Pritjet për punësim në tre muajt e ardhshëm	19
Figura 6: Pritjet për punësim: Balanca.....	20
<i>Figura 7: Pritjet për 6 muajt e ardhshëm sa i përket situatës biznesore.....</i>	<i>21</i>
Figura 8: Pritjet për 6 muajt të ardhshëm: balanca.....	21
Figura 9: Balanca: gjendja aktuale, pritjet për 6 muajt e ardhshëm dhe klima e biznesit.	22
Figura 10: Gjendja aktuale biznesore në bazë të sektorëve	23
Figura 11: Pritjet për punësim në bazë të sektorëve	23
Figura 12: Pritjet për gjashtë muajt e ardhshëm në bazë të sektorëve	24
Figura 13: Prodhimi në 3 muajt e fundit (% e kompanive)	25
Figura 14: Prodhimi në tre muajt e ardhshëm.....	26
Figura 15: Çmimet e produkteve në sektorin e prodhimit	26
Figura 16: Pritjet e kompanive për eksport të produkteve të tyre.....	27
Figura 17: produktet e zhvilluara nga kompanitë në vitin 2023	28
Figura 18: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të prodhimit.	29
Figura 19: gjendja e biznesit në tre muajt e fundit.....	31
Figura 20: pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive).....	32
Figura 21: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të shërbimeve.....	32
Figura 22:Zhvillimi i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)	34
Figura 23: Figure 11 Pritjet e kompanive për qarkullimin e tyre në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)	35
Figura 24: Pritjet e kompanive në sektorin e ndërtimit për tre muajt e ardhshëm sa i përket çmimeve.....	35
Figura 25: Shfrytëzimi i kapaciteteve nga kompanitë e ndërtimit.....	37
Figura 26: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të ndërtimit.....	37
Figura 27: Vlerësimi i bizneseve rreth gjendjes biznesore në tre muajt e fundit (% e kompanive)	39
Figura 28: Pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive).....	40
Figura 29: Pritjet e kompanive të sektorit të tregtisë me shumicë për tre muajt e ardhshëm lidhur me porositë tek furnitorët	40
Figura 30: Pritjet e kompanive të tregtisë me shumicë sa i përket çmimit të produkteve për 3 muajt e ardhshëm	41
Figura 31: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të tregtisë me shumicë	42
Figura 32: Vlerësimi i gjendjes së biznesit nga kompanitë e tregtisë me pakicë në tre muajt e fundit (% e kompanive)	43
<i>Figura 33: Pritjet në lidhje më aktivitetin e biznesit në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)</i>	<i>44</i>
Figura 34: Pritjet e sektorit të tregtisë me pakicë për çmimit të produkteve për 3 muajt e ardhshëm	44
Figura 35: barrierat në sektorin e tregtisë me pakicë.....	45

Figura 36: Ndikimi i liberalizimit të vizave në sektorin privat të Kosovës	46
Figura 37: Sfidat dhe mundësitë nga liberalizimi i vizave në Kosovë	47
Figura 38: Sfidat dhe mundësitë nga liberalizimi i vizave në Kosovë sipas sektorëve	48
Figura 39: Barrierat e të bërit biznes në Kosovë.....	50

Lista e tabelave

Table 1: Mostra në bazë të sektorëve dhe madhësisë së kompanive të anketuara.....	14
Table 2: Mostra në bazë të rajoneve dhe sektorëve të anketuar	14

Përmbledhje ekzekutive

Studimi "Klima e Biznesit në Kosovë" për tremujorin e katërt të vitit 2023, zhvilluar nga Oda Ekonomike e Kosovës, paraqet një përmbledhje të rëndësishëm të situatës së biznesit në vend. Ky studim shërben si një indikator matës i tendencës në biznes dhe ka për qëllim të ofroj informacion të besueshëm dhe në kohë për zhvillimet ciklike në ekonomi, informacione shtesë të rëndësishme të të dhënave statistikore kuantitative që publikohen me vonesë, mundësinë e vlerësimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike si dhe identifikon ndryshime në ciklin e biznesit në kohë ose edhe paraprakisht. Komisioni Evropian sugjeron realizimin e studimeve të harmonizuara për tendencën në biznes në të gjitha vendet anëtare. Metodologjia e këtij studimi është dizajnuar nga ekspertë gjermanë nga Instituti IFO në Gjermani dhe përdorët si indikatorë në më shumë se 100 shtete. Përdoret nga qeveritë e shumë vendeve për marrjen e vendimeve dhe parashikimin e treguesve ekonomik.

Monitorimi i gjendjes së bizneseve konsiderohet një burim informacioni me shumë rëndësi në aktivitetin ekonomik, pasi që mostra e këtij studimi është panel, ku gjendja e bizneseve monitorohet te të njëjtat kompani që nga viti 2013. Informacionet që rrjedhin nga anketat iu lehtësojnë marrjen e vendimeve udhëheqësve të biznes dhe politikë-bërësve. Gjithashtu edhe investitorët direkt dhe të huaj kërkojnë informacione të tilla. Anketat fokusohen në 5 sektorë: prodhim, ndërtim, shërbim, tregti me shumicë dhe pakicë. Kjo anketë mbledh informacione nga menaxherët e bizneseve gjatë vlerësimit të tyre për situatën biznesore, synimet dhe pritshmëritë për të ardhmen e afërt.

Situata e përgjithshme e biznesit sipas këtij studimi konsiderohet të jetë e favorshme. Indeksi i klimës së biznesit IFO për Kosovë në tremujorin e katërt të vitit 2023 ka shënuar një rritje të konsiderueshme në 48 pikë. Në krahasim me tremujorin paraprak ka shënuar një rritje prej 23 pikë përqindje. Kjo rritje e konsiderueshme është shfaqur për shkak të vlerësimeve pozitive të kompanive për gjendjen aktuale dhe pritjeve për përmirësim të situatës biznesore në gjashtë muajt e ardhshëm. Indikator i konfidencës ka pësuar një rënie të lehtë në tremujorin e katërt të vitin 2023 në krahasim me tremujorin paraprak prej 7 p.p. dhe është 22. Kjo rënie është reflektuar nga deklaratimet më pak optimiste të sektorit të prodhimit dhe ndërtimit.

Sipas vlerësimeve të sektorit privat në Kosovë, gjendja e biznesit është e favorshme rreth 90% e kompanive të anketuara kanë pasur vlerësime pozitive rreth gjendjes tyre biznesore. Pritjet për punësim për tre muajt e ardhshëm janë pozitive rreth 32% e bizneseve pjesëmarrëse presin të rrisin numrin e punëtorëve dhe rreth 62% presin që numri i punëtorëve të mbetet i pandryshuar. Në periudhën gjashtëmujore, kompanitë e anketuara presin që aktiviteti i tyre biznesor të përmirësohet dhe të kenë një situatë më të mirë biznesore kjo kryesisht për shkak të sezonës së verës ku mërgata jonë vjen në Kosovë. Rreth 80% e bizneseve të intervistuar presin që aktiviteti biznesor të përmirësohet, ndërsa 18% e tyre presin që gjendja të mbetet e njëjtë. Si përfundim, bizneset raportuan një gjendje të favorshme në aspektin e aktivitetit ekonomik, e cila përputhet me një parashikim optimist për periudhën e ardhshme.

Megjithatë, gjatë kësaj periudhe kompanitë kanë raportuar se përballen me një sërë barrierash gjatë operimit të tyre. Ndër barrierat më të raportuara nga kompanitë janë:

- **Mungesa e Stafit me Shkathtësi Adekuate:** 57% e kompanive raportojnë se përballen me këtë problem, që ndikon në aftësinë e kompanisë për të përmbushur objektivat dhe për të operuar një mjedis konkurrues.
- **Konkurrenca Jolojale:** 37% e kompanive shprehin shqetësim për konkurrencën jolojale, e cila mund të kufizojë rritjen dhe zhvillimin e tyre në treg;
- **Mungesa e Mjeteve Financiare:** 28% e kompanive identifikojnë këtë barrierë si pengesë për rritjen e tyre, duke i bërë ato të varura nga burimet e financimit për investime dhe operacione të nevojshme;
- **Normat e Larta të Interesit:** 21% e kompanive e raportojnë si barrierë normat e larta të interesit;
- **Prania e Ekonomisë Informale:** 20% e kompanive kanë shprehur se ekonomia informale është një barrierë me të cilën përballen dhe se u sjell sfida që të lidhen me integritetin e tregut.

Për të adresuar këto barrierë, duhet të rritet bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe sektorin publik për të siguruar trajnimin dhe aftësimin e nevojshëm për fuqinë punëtore, të zhvillohen strategji të përshtatshme nga kompanitë, për të përmirësuar rekrutimin dhe trajnimin e stafit, zhvillimin e strategjive konkurruese të diferencuara, dhe përmirësimin e qasjes në burimet e financimit.

Rekomandimet që dalin nga ky raport janë si në vijim: Mbështetje në zhvillimin e fuqisë punëtore; Rritje e transparencës dhe zbatimi i ligjit; Zhvillimi i mekanizmave financiare për mbështetjen e kompanive; dhe Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe sektorin publik.

Hyrje

Rritja ekonomike e Kosovës parashikohet të përshpejtohet në vitin 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe investimeve. Në Kosovë, si kudo në Ballkanin Perëndimor, në mes të kushteve sfiduese të jashtme, rritja reale e PBB-së u ngadalësua, por ajo megjithatë mbetet pozitive. Aktiviteti ekonomik pritet të zgjerohet me 3.2 për qind gjatë vitit 2023. Inflacioni ka qenë në rënie të vazhdueshme nga kulmi i tij prej 14.2 për qind në korrik 2022, por presionet mbi çmimet mbeten të rritura. Kontributi i investimeve në rritje ekonomike pritet të rritet në 2024-2025, i mbështetur nga rritja e investimeve në infrastrukturën publike, duke përfshirë mbështetjen e financimit të jashtëm, dhe investimet më të larta publike dhe private në furnizimin dhe efikasitetin e energjisë, thotë Raporti i ri Ekonomik i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor.

Sipas FMN-së, Investimet e Huaja Direkte mbeten të kufizuara ndërsa remitancat nga diaspora vazhdojnë të jenë shtytësi kryesor ekonomik i vendit, duke nënvizuar nevojën që Kosova të diversifikojë burimet e rritjes ekonomike.

NVM-të në Kosovë luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, ato përbëjnë 99 % të të gjitha firmave në Kosovë. Promovimi i vazhdueshëm i një kornize të shëndoshë të investimeve dhe zhvillimit të sektorit privat duhet të mbetet fokusi i politikëbërësve në Kosovë. Kjo nënkupton që burime të mjaftueshme kombëtare duhet të ndahen për strategji dhe mekanizma që ndikojnë në zhvillimin e sektorit privat.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit privat në zhvillimin ekonomik të një vendi, Oda Ekonomike e Kosovës që nga vitit 2013 realizon këtë analizë të monitorimit të gjendjes së bizneseve me qëllim të vlerësimit të klimës së biznesit në vend. Të gjeturat e këtij studimi shërbejnë si një mjet kyç për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse për udhëheqësit e biznesit dhe politikëbërësit. Përveç kësaj, investitorët, si vendas ashtu edhe të huaj, kërkojnë dhe vlerësojnë këto informacione për të bërë vendime të informuara për investime të mundshme.

Ky raport ofron një analizë të hollësishme rreth vlerësimit të gjendjes aktuale biznesore, si dhe pritshmëritë e bizneseve për të ardhmen në një periudhë të afërt. Përveç kësaj, raporti përmban informacione të detajuara për sektorët kryesor ekonomik, duke përfshirë prodhimin, ndërtimin, shërbimet, tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë. Për secilin sektor, analizohen vlerësimet e kompanive në lidhje me situatën e tanishme biznesore, pritjet për numrin e punëtorëve në tre muajt e ardhshëm, si dhe pritjet për gjendjen biznesore në periudhën gjashtëmujore të ardhshme.

Këto informacione të detajuara ofrojnë një pamje të plotë të gjendjes së përgjithshme të biznesit dhe sektorëve kryesor në ekonominë e Kosovës, duke e bërë të mundur për vendimmarrësit dhe politikëbërësit të marrin vendime të informuara dhe të përshtatshme për të promovuar rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Raporti është strukturuar nëpër disa seksione për të prezantuar një përmbledhje të hollësishme të studimit. Në mënyrë specifike, raporti është organizuar në këtë mënyrë: Në seksionin e parë, behet një përshkrim i metodologjisë së përdorur për realizimin e studimit. Në seksionin 2, janë prezantuar të gjeturat kryesore të studimit duke përfshirë indeksin e klimës së biznesit, indikatorin e konfidencës, situatën aktuale, etj.. Në seksionin 3, janë paraqitur të gjeturat duke përdorur një perspektivë sektoriale. Seksioni katërt, përmban informata rreth ndikimit të liberalizimit të vizave te sektori privat. Në seksionin 5, janë identifikuar barrierat e të bërit biznes dhe masat për adresimin e këtyre barrierave. Së fundi, janë paraqitur konkluzionet dhe rekomandimet.

1. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij studimi bazohet në të dhëna primare, të cilat janë grumbulluar nga ekipi anketues i OEK-ut gjatë periudhës shkurt – mars, 2024. Anketat kryhen në baza tre mujore për qëllime të këtij studimi dhe ofrojnë detaje të rëndësishme për perceptimin dhe vlerësimin e situatës aktuale të biznesit nga kompanitë vendase. Kjo metodologji e vlerësimit siguron një pamje periodike të situatës së bizneseve dhe identifikon ndryshimet ciklike në ekonomi.

Për realizimin e studimit, është përdorur një mostër prej 441 kompanive e stratifikuar në shtatë rajonet kryesore të Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Pejën, Prizrenin, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën dhe Ferizajin. Bazuar në bazën e të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës, mostra është shpërndarë në tërë Kosovën në tri grupe sipas madhësisë së kompanive (0-9; 10-49; 50 e më shumë).

Intervistat janë realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes pyetësorëve online. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar dhe analizuar nga Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Komunikim Strategjik brenda OEK-ut përmes platformës surveymonkey dhe SPSS. Hulumtimit i monitorimit të biznesit ka për qëllim të mbledhë informacione nga menaxherët e bizneseve në lidhje me situatën ekonomike, qëllimet dhe pritshmëritë për të ardhmen e afërt.

Pyetësorët për pesë sektorët e intervistuar janë dizajnuar që të mbledhin pikëpamjet e menaxherëve të lartë në lidhje me çështjet si: situata e biznesit, volumi i prodhimit, porositë, çmimi dhe punësimi, për të vlerësuar natyrën e biznesit. Pyetjet janë formuluar me opsione të shumëfishta për të vlerësuar zhvillimet në tre muajt e fundit, situatën aktuale dhe pritjet për tre deri në gjashtë muajt e ardhshëm. Përgjigjet janë të strukturuar në kategori si "rritje, ka mbetur e pandryshuar, rënie" ose "përmirësuar, e pandryshuar, përkeqësuar", duke përdorur një shkallë me tre pikë për opsionet e përgjigjeve.

Për të rritur më tej përfaqësimin mostra është stratifikuar sipas sektorëve kryesore që kontribuojnë në ekonomi, si në vijim: Prodhimi (përpunimi i ushqimit, përpunimi i drurit, përpunimi i metaleve dhe materialeve ndërtimore), Ndërtimi, Tregtia me Shumicë dhe Pakicë, dhe Shërbimet (transporti, shërbimet profesionale, hotelet dhe restorantet). Mostra dominohet nga kompanitë e vogla, kjo pasi që 99% e kompanive në Kosovë janë kompani të vogla, ndërsa 1% të mesme dhe të mëdha.

Në tabelën 1 janë paraqitur të dhënat rreth mostrës në bazë të ndarjes sipas sektorëve dhe madhësisë së kompanive. Siç mund të shihet nga tabela kategorizimi i madhësisë nuk është bërë në përputhje me kategorizimet standarde, por që ky lloj kategorizimi aplikohet nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Table 1: Mostra në bazë të sektorëve dhe madhësisë së kompanive të anketuara

Sektorët	Pyetësorët	%	Të vogla (0 – 9)	Të mesme (10 – 49)	Të Mëdha (> 50)
Prodhim	96	21.7	10.43	7.5	6.6
Shërbime	108	24.4	16.2	5.2	2.5
Ndërtim	55	12.3	2.2	4.2	3.2
Tregti me pakicë	108	24.5	15.5	6.1	1.5
Tregti me shumicë	74	17.1	10	6.9	2
Gjithsej	441	100	54	30	16
Përqindja në bazë të madhësisë së kompanive			54.3%	29.90%	15.8%

Në vijim tabelën 2, paraqet ndarja e mostrës në bazë të rajoneve dhe sektorëve të intervistuar me qëllim të realizimit të studimit.

Table 2: Mostra në bazë të rajoneve dhe sektorëve të anketuar

Rajonet	Pyetësorët	%	Prodhim	Shërbimet	Ndërtim	Tregti me pakicë	Tregti me shumicë
Prishtinë	123	27.9	18	37	24	21	22
Mitrovicë	41	9.2	10	9	2	17	2
Pejë	50	11.4	9	11	2	21	7
Prizren	79	18	26	15	10	14	14
Ferizaj	61	14.0	11	10	5	17	18
Gjilan	40	8.7	11	12	3	10	2
Gjakovë	47	10.8	10	13	8	7	9
Gjithsej	441	100	95	107	54	107	74
Përqindja në bazë të madhësisë së kompanive			21.7%	24.4%	12.3%	24.5%	17.1%

2. Gjetjet Kryesore të Analizës

2.1. Gjetjet kryesore: Indeksi i Klimës së Biznesit në Kosovë

Përkufizimi i klimës së biznesit nuk është i thjeshtë dhe homogjen. Nuk ekziston një përkufizim zyrtar. Mund të dallojmë disa lloje përkufizimesh. I pari, bazohet në opinionin e ndërmarrësve për një periudhë afatshkurtër. Zyrat kombëtare të statistikave pyesin, për shembull, çdo 3 muaj, ndërmarrësit për mendimin e tyre për situatën ekonomike në periudhë afatshkurtër (zhvillimet e kërkesës, prodhimit, stoqeve, çmimeve, porosive, fuqisë punëtore të tyre, etj.). Është një tregues cilësor i bazuar në opinionin personal të ndërmarrësve vendas. Përkufizimi i dytë, konsiston në matjen e treguesve makroekonomikë edhe për një periudhë afatshkurtër. Për shembull, trendi i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), konsumit të brendshëm, eksporteve, investimeve të brendshme dhe i bilancit të sektorit publik, etj. (Uzunidis, 2013).


Indikatori për klimën e biznesit si matës i aktivitetit ekonomik në një vend është mesatarja aritmetike e vlerësimit të situatës aktuale dhe pritjeve për biznes për gjashtë muajt e ardhshëm, pra është kombinim i pritjeve me vlerësimin e situatës aktuale. Ky lloj informacioni është shumë i rëndësishëm për investitorët e huaj. Në rastin e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës vlerëson opinionin e ndërmarrësve në baza tremujore për situatën biznesore.

Indeksi i klimës së biznesit IFO për Kosovë në tremujorin e katërt të vitit 2023 ka shënuar një rritje të konsiderueshme në 48 pikë. Në krahasim me tremujorin paraprak ka shënuar një rritje prej 23 pikë përqindje. Kjo rritje e konsiderueshme është shfaqur për shkak të vlerësimeve pozitive të kompanive për gjendjen aktuale dhe pritjeve për përmirësim të situatës biznesore në gjashtë muajt e ardhshëm.

Rritja e konsiderueshme e indeksit të klimës së biznesit shfaq një shenjë të rëndësishme të besimit të kompanive në perspektivën pozitive të kushteve të tregut dhe të mundësive të tyre të zhvillimit. Kjo ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që përfshijnë politikat ekonomike, ndryshimet në kërkesë dhe oferta të tregut, si dhe zhvillimet globale ekonomike.

Në figurën e mëposhtme, lehtë mund të evidentohen ndryshimet ciklike në ekonominë e vendit tonë varësisht nga ndikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në periudha të caktuara, si periudha e pandemisë Covid-19, indeksi ka prekur nivele të ulëta, duke arritur në pikën më të ulët prej vitit 2013, me një vlerësim në -37. Kjo tregon për ndikimin e ngjarjeve të pazakonta dhe rëndësinë e monitorimit të rregullt të tregut dhe pritjeve të biznesit për të identifikuar dhe adresuar sfidat dhe mundësitë në një mënyrë efektive.

Figura 1: Indeksi i klimës së biznesit IFO në Kosovë



2.2. Gjetjet Kryesore: Indikator i Konfidencës së Biznesit


Ky tregues i besimit të biznesit jep informacion mbi zhvillimet e ardhshme, bazuar në anketat e opinionit me ndërmarrësit mbi zhvillimet në prodhim, porositë dhe stoqet e produkteve të gatshme në sektorin e industrisë. Mund të përdoret për të monitoruar rritjen e prodhimit dhe për të parashikuar pika kthese në aktivitetin ekonomik (OECD, 2024).

Ndryshe nga treguesi i klimës së biznesit, i cili fokusohet kryesisht në situatën e fitimit të ndërmarrjeve, treguesi i besimit të biznesit ka një orientim më shumë në aktivitetin e përgjithshëm të biznesit, duke përfshirë të dy aspektet aktuale dhe pritshme, pa marrë parasysh se sa fitimprurës mund të jetë. Kjo e bën atë një instrument më të përshtatshëm për vlerësimin e përgjithshëm të ekonomisë dhe për parashikimin e tendencave të ardhshme. Treguesi i besimit është përdorur gjerësisht në analizën ekonomike të Komisionit Evropian dhe është në dispozicion për të gjitha vendet anëtare të BE.

Në lidhje me situatën specifike të tremujorit të katërt të vitit 2023, raportohet një rënie e lehtë në treguesin e konfidencës të biznesit, përkatësisht një rënie prej 7 pikë përqindje në krahasim me tremujorin paraprak, duke arritur në nivelin 22. Kjo rënie është reflektuar nga deklaratimet më pak optimiste të sektorit të prodhimit dhe ndërtimit, të cilat kanë ndikuar në vlerësimin e përgjithshëm të besimit të biznesit për këtë periudhë. Këto ndryshime në treguesin e besimit të biznesit mund të interpretohen si shenja e ndryshimeve në kushtet e tregut dhe të klimës së

biznesit, dhe mund të përdoren si informacion për vlerësimin e tendencave të ardhshme ekonomike.

Figura 2: Indikator i konfidencës së biznesit




2.3. Gjetjet Kryesore: Vlerësimi i Gjendjes Aktuale nga Bizneset

Sipas vlerësimeve të sektorit privat në Kosovë për tremujorin e katërt të vitit 2023, duket se gjendja e biznesit ka pasur një përmirësim të konsiderueshëm. Rreth 43% e kompanive kanë vlerësuar se ata kanë një gjendje të mirë, ndërsa 47% kanë një gjendje të kënaqshme biznesore. Kjo do të thotë se rreth 90% e kompanive të anketuara kanë pasur vlerësime pozitive për gjendjen e tyre biznesore gjatë këtij tremujori.

Në krahasim me tremujorin e kaluar, ku gjendja e bizneseve ishte vlerësuar më pak e favorshme, përmirësimi është i ndjeshëm, me një rritje prej 30 p.p. Kjo tregon për një qëndrim më pozitiv të kompanive në lidhje me kushtet e biznesit dhe për një rritje të besimit në perspektivën e tyre afatmesme.

Ky përmirësim i ndjeshëm i vlerësimeve pozitive për gjendjen e biznesit përjetuar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 mund të interpretohet si rezultat i faktorëve të ndryshëm, përfshirë ndryshimet në kushtet e tregut, si dhe përmirësimet e performancës së tyre. Kjo gjithashtu mund të jetë një shenjë e stabilitetit dhe rritjes së ekonomisë së vendit.


Figura 3: Vlerësimi i gjendjes aktuale nga bizneset



Balanca tregon diferencën në mes të vlerësimit pozitiv dhe atij negativ. Ashtu siç pasqyrohet edhe tek gjendja aktuale, balanca paraqitet me një trend në rritje. Kjo për shkak se në këtë tremujor vlerësimet e biznesit janë më optimiste në krahasim me tremujorin paraprak.

Në bazë të të dhënave të paraqitura në figurën e mëposhtme, përmes vijës së trendit vërejmë se varësisht ndryshimeve ciklike në ekonomi, gjendja ekonomike ka qenë stabile në 10 vitet e fundit.


Figura 4: Vlerësimi i gjendjes aktuale: Balanca



2.4. Gjetjet Kryesore: Pritjet për Punësim për Tre (3) Muajt e Ardhshëm


Pritjet për punësim për tre muajt e ardhshëm janë pozitive. Përderisa në tremujorin e tretë të vitit 2023, 11% e kompanive pritnin të rritnin numrin e punëtorëve, në këtë tremujor rreth 32% e kompanive presin që të rrisin numrin e punëtorëve. Megjithatë, pavarësisht këtij përmirësimi në pritje të bizneseve, rreth 62% e kompanive të intervistuar presin që ta mbajnë numrin e njëjtë të punëtorëve në tre muajt e ardhshëm. Vetëm një përqindje e vogël prej 6% e bizneseve kanë pritje negative.

Figura 5: Pritjet për punësim në tre muajt e ardhshëm



Balanca është paraqitur me trend në rritje. Kjo për shkak se pritshmëritë pozitive për punësim janë rritur në këtë tremujor në krahasim me tremujorin paraprak.

Figura 6: Pritjet për punësim: Balanca




2.5. Gjetjet Kryesore: Pritjet për Gjashtë (6) Muaj e Ardhshëm

Pritjet për gjashtëmujorin e ardhshëm shfaqen shumë optimiste, duke reflektuar një perceptim pozitiv të situatës së biznesit në të ardhmen. Rreth 80% e kompanive të anketuara kanë vlerësuar se situata e tyre biznesore pritet të përmirësohet gjatë 6 muajve të ardhshëm. Kjo është një shifër e lartë e optimizmit dhe tregon për një besim të thellë në perspektivën pozitive të aktivitetit ekonomik dhe të kërkesës për produkte dhe shërbime në të ardhmen.

Një nga arsyet kryesore të këtij optimizmi është sezoni i verës, i cili shpesh shoqërohet me një rritje të kërkesës për produkte dhe shërbime. Në veçanti, kërkesa rritet për shkak të fluksit të lartë të vizitorëve nga mërgata, që përfshinë turistët dhe vizitorët e tjerë që shfrytëzojnë këtë periudhë për pushime.


Këto pritje të larta për përmirësimin e situatës biznesore përforcojnë besimin e kompanive në potencialin e rritjes dhe suksesit të tyre në treg. Një përmirësim i kësaj natyre do të mund të kontribuojë në rritjen e performancës së tyre financiare dhe në kontributin e tyre në ekonominë e përgjithshme.

Figura 7: Pritjet për 6 muajt e ardhshëm sa i përket situatës biznesore




Balanca tregon një trend në rritje kjo për shkak të rritjes së vlerësimeve pozitive të sektorit privat sa i përket parashikimeve të tyre për gjendjen biznesore në gjashtë muaj e ardhshëm.

Figura 8: Pritjet për 6 muajt e ardhshëm: balanca



Në figurën e mëposhtme është paraqitur balanca e gjendjes aktuale, pritjeve për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe klimës së biznesit. Në bazë të të dhënave në figurë konfirmohet se gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 bizneset raportuan një gjendje të favorshme në aspektin e aktivitetit ekonomik, e cila përputhet me një parashikim optimist për periudhën e ardhshme.


Figura 9: Balanca: gjendja aktuale, pritjet për 6 muajt e ardhshëm dhe klima e biznesit.



2.6. Gjetjet Kryesore nga Perspektiva Sektoriale


Bazuar në të dhënat e prezantuara në figurë, evidentohet se nuk ka shumë dallime në mes të sektorëve në aspektin e gjendjes aktuale të biznesit të tyre. Megjithatë, sektori i tregtisë me shumicë ka raportuar të ketë një performancë pak më të mirë në krahasim me sektorët e tjerë.

Figura 10: Gjendja aktuale biznesore në bazë të sektorëve




Njëjtë si në figurën e sipërme, pritjet për punësim ndër sektorë nuk shfaqin dallime të konsiderueshme. Megjithatë, mund të vërejmë se sektori i ndërtimit ka pritje më të larta për rritjen e numrit të punëtorëve në krahasim me sektorët e tjerë. Koncretisht, 42% e kompanive të anketuara në këtë sektor raportuan që presin të rrisin numrin e punëtorëve të tyre, ndjekur nga sektori i shërbimeve me 35% dhe sektori i prodhimit me 34%.

Figura 11: Pritjet për punësim në bazë të sektorëve



Në figurën 12, janë paraqitur pritjet e bizneseve për parashikimin e situatës biznesore në gjashtë muajt e ardhshëm. Sektori i prodhimit dhe sektori i shërbimeve kanë pasur pritjet më optimiste asnjë biznes nuk ka raportuar se do të ketë një zhvillim të pafavorshëm.

Figura 12: Pritjet për gjashtë muajt e ardhshëm në bazë të sektorëve.



3. Gjetjet Kryesore të Analizës së Sektorëve


3.1. Sektori i Prodhimit

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sektori i prodhimit në Kosovë shënoi një aktivitet të konsiderueshëm ekonomik gjatë këtij tremujori, me 253 biznese të reja të hapura. Ndër këto, 68 ishin biznese individuale, 172 ishin të kategorizuara si biznese të vogla dhe të mesme, ndërsa 13 prej tyre ishin të klasifikuar si biznese të mëdha. Gjatë tremujorit të parë, sektori i prodhimit raportoi mbylljen e 42 bizneseve.

Gjetjet e paraqitura në figurën e mëposhtme ofrojnë një analizë të aktivitetit prodhues gjatë tre muajve të fundit, duke reflektuar një pasqyrë të performancës së kompanive. Evidentohet se rreth 33% e kompanive të anketuara raportuan një rritje të aktivitetit prodhues gjatë këtij tremujori. Ky rezultat tregon për një ngjallje të optimizmit dhe rritjes në sektorin e prodhimit për një pjesë të kompanive. Në të njëjtën kohë, rreth 60% e kompanive raportuan se situata e tyre ka qëndruar e pandryshuar gjatë kësaj periudhe tremujore.

Megjithatë, është rëndësishme të theksohet se rreth 7% e kompanive prodhuese raportuan një rënie gjatë këtij tremujori. Kjo mund të jetë rezultat i sfidave të ndryshme, siç janë konkurrenca, kosto shtesë, ose kushte të tjera të tregut që kanë influencuar negativisht performancën e tyre.

Figura 13: Prodhimi në 3 muajt e fundit (% e kompanive)




Pritjet për prodhim në tremujorin e ardhshëm shfaqen shumë të favorshme, sipas të dhënave të prezantuara. Rreth 71% e kompanive parashikojnë një rritje të prodhimit për këtë periudhë. Ky nivel i optimizimit dhe përkushtimit për rritje tregon për një perceptim pozitiv të kushteve të tregut dhe mundësive për rritje të kërkesës për produktet e tyre.

Në anën tjetër, një pjesë prej 29% e kompanive presin që të mbajnë nivelin e njëjtë të prodhimit gjatë tremujorit të ardhshëm.


Këto pritje pozitive për rritjen e prodhimit tregojnë për një qëndrim pozitiv të kompanive dhe shprehin besimin në rritjen e aktivitetit prodhues në të ardhmen e afërt. Kjo mund të ndikojë pozitivisht në rritjen e prodhimit dhe në kontributin e sektorit të prodhimit në ekonominë e përgjithshme.

Figura 14: Prodhimi në tre muajt e ardhshëm




Në sektorin e prodhimit, analiza tregon se rreth 19% e kompanive raportuan një rritje në çmimet e produkteve të tyre, gjatë periudhës së vlerësuar dhe shumica prej 75% e kompanive nuk raportuan ndonjë ndryshim në çmimet e produkteve të tyre.

Figura 15: Çmimet e produkteve në sektorin e prodhimit




Referuar të dhënave në figurën e mëposhtme, rreth 45 % e kompanive presin që të rrisin vëllimin e eksportit të produkteve të tyre. Kjo tregon një shkallë të njohurisë dhe optimizmi të tyre në lidhje me mundësitë e rritjes së tregut ndërkombëtar për produktet e tyre. Në të njëjtën kohë, rreth 25% e kompanive parashikojnë që sasia e eksportit të mbetet e njëjtë. Këto informacione janë të rëndësishme për të kuptuar pritjet dhe strategjitë e kompanive në lidhje me tregun ndërkombëtar dhe zhvillimin e eksportit të tyre.

Figura 16: Pritjet e kompanive për eksport të produkteve të tyre



Në figurën 17 paraqitet përqindja e kompanive që kanë zhvilluar produkte të reja gjatë vitit 2023. Rreth 41% e kompanive kanë raportuar se kanë zhvilluar produkte të reja gjatë vitit 2023. Kjo tregon për një performancë të mirë të sektorit të prodhimit dhe një angazhim të vazhdueshëm në inovacion dhe zhvillim të produkteve, që mund të ndihmojë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe në sigurimin e rritjes së afatgjatë të sektorit të prodhimit. Këto gjetje përcaktojnë një dinamikë pozitive dhe një potencial të konsiderueshëm për rritje dhe zhvillim në sektorin e prodhimit.

Figura 17: produktet e zhvilluara nga kompanitë në vitin 2023




Në figurën 18, paraqitet një analizë e barrierave që kompanitë në sektorin e prodhimit hasin gjatë operacioneve të tyre. Evidentohet se një prej barrierave kryesore është mungesa e stafit me shkathësi të adekuate, e raportuar nga rreth 70% e kompanive. Ky rezultat është shqetësues dhe rrit nevojën për zhvillimin e programeve të trajnimit dhe rekrutimit për të përmirësuar bazën e stafit me aftësi të nevojshme në këtë sektor.

Në vijim, evidentojmë se një barrierë tjetër që është raportuar më shumë nga sektori i prodhimit është kostoja e energjisë elektrike, e raportuar nga rreth 55% e kompanive. Kjo tregon se kostoja e energjisë është një shqetësim i rëndësishëm për kompanitë prodhuese dhe mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në kostot operative dhe konkurrueshmërinë e tyre në treg.

Vështirësinë në gjetjen e fuqisë punëtore e raportojnë rreth 43% e kompanive. Kjo është pasojë e mospërshtatjes së kërkesës dhe ofertës në tregun e punës, përqendruar në aftësitë specifike të kërkuara për prodhimin.

Më shumë barrierat të raportuara nga kompanitë gjeni në figurën e mëposhtme. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme për sfidat që përballet sektori i prodhimit dhe mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e politikave dhe strategjive për të adresuar këto çështje në të ardhmen.

Figura 18: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të prodhimit.




3.2. Sektori i Shërbimeve

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në tre mujorin e katërt të vitit 2023, një numër prej 244 ndërmarrje janë regjistruar në sektorin e shërbimeve me ushqim, ndërsa 165 kompani janë regjistruar për shërbime të tjera. Në të njëjtën periudhë, 44 kompani nga aktivitetet e shërbimeve ushqimore dhe 34 kompani me aktivitete tjera shërbyese janë shuar. Ndërkaq, zhvillimi i këtij sektori ka patur një rritje në ekonominë e vendit, veçanërisht që pas kohës së pandemisë Covid-19. Kjo ka treguar se ndërmarrjet kanë përshtatur bizneset e tyre në një mjedis të ndryshuar, duke u fokusuar në nevojat e tregut dhe duke ofruar shërbime inovative për të përmbushur kërkesat e klientëve.


Në figurën e mëposhtme janë paraqitur vlerësimet e kompanive të sektorit të shërbimeve në lidhje me situatën biznesore në tre muajt e fundit. Në bazë të evidencës së marrë nga kompanitë që operojnë në këtë sektor 29% e kompanive deklaruan se gjendja e biznesit në tre muajt e fundit është përmirësuar dhe 65% e tyre kanë situatë të pandryshuar në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Figura 19: gjendja e biznesit në tre muajt e fundit



Sa i përket pritjeve për tre muajt e ardhshëm, një zhvillim të favorshëm apo rritje të qarkullimit presin të kenë rreth 58% e bizneseve të anketuara. Ndërsa, 39% e kompanive deklaruan se qarkullimi në tre muajt e ardhshëm do të mbetet i pandryshuar. Kështu, perspektiva e përgjithshme e këtij sektori për tre muajt e ardhshëm duket të jetë shumë optimiste, duke reflektuar një besim në rritjen dhe zhvillimin e biznesit në këtë periudhë kohore.

Figura 20: pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)




Në bazë të analizës, barrierat që kompanitë në sektorin e shërbimeve hasin gjatë operacioneve të tyre janë:

- Mungesa e stafit me shkathësi adekuate (51%): Kjo është një problem që shfaqet shpesh në sektorin e shërbimeve. Një mungesë e stafit me aftësi të duhura mund të çojë në performancë të ulët dhe shërbime të dobëta për klientët.
- Konkurrenca jolojale (36%): Konkurrenca jolojale është një tjetër barrierë e raportuar nga kompanitë në sektorin e shërbimeve.
- Vonesat në pagesa nga konsumatorët (29%): Kjo është një barrierë që ndikon në likuiditetin dhe stabilitetin financiar të kompanive në sektorin e shërbimeve. Vonesat në pagesa mund të shkaktojnë vështirësi në menaxhimin e flukseve të ardhurave.

Më shumë informata rreth barrierave të sektorit të shërbimeve gjeni në figurën 21.

Figura 21: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të shërbimeve




3.3. Sektori i Ndërtimit

Sektori i ndërtimit në tre mujorin e katërt të vitit 2023 kishte të regjistruara gjithsej 283 biznese në të gjitha rajonet ku 282 biznese ishin biznese të vogla dhe të mesme. Ndërsa 1 biznes ishte i kategorisë së bizneseve të mëdha. Gjatë këtij tre mujori ishin 21 biznese të shuara. (Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve, TM4 2023).

Gjetjet e paraqitura në figurën e mëposhtme, tregojnë se kompanitë në sektorin e ndërtimit konsiderojnë se zhvillimi i aktivitetit të biznesit të tyre në 3 muajt e fundit ka mbetur relativisht i njëjtë si në tremujorin e njëjtë të vitit 2022. Përkatësisht, për rreth 67% të kompanive të ndërtimit, situata e tyre biznesore ka mbetur relativisht e njëjtë, pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm krahasuar me tre mujorin e vitit të kaluar. Në anën tjetër, rreth 21% e kompanive të ndërtimit raportuan një ngritje në situatën e tyre biznesore në krahasim me tre mujorin e vitit të kaluar. Kjo është një tregues i mirë për rritjen në sektorin e ndërtimit, për shkak të rritjes së kërkesës për shërbime ndërtimi ose për shkak të realizimit të projekteve të reja.


Figura 22: Zhvillimi i biznesit në tre muajt e fundit (% e kompanive)



Në sektorin e ndërtimit, perspektiva për tremujorin e ardhshëm duket të jetë shumë optimiste, duke u bazuar në të dhënat e prezantuara në figurën e mëposhtme. Sipas rezultateve, 60% e bizneseve në këtë sektor presin që të shohin një rritje të qarkullimit të tyre. Kjo është një shenjë pozitive për rritjen e aktivitetit në sektorin e ndërtimit, gjë që mund të interpretohet si një indikacion i rritjes së kërkesës për ndërtime. Në anën tjetër, 35% e bizneseve presin që qarkullimi i tyre të mbetet i njëjtë. Kjo nuk është një perspektivë negative në vetvete, pasi mbajtja e një niveli të qëndrueshëm të qarkullimit mund të reflektojë stabilitet në treg dhe një situatë të qëndrueshme për këto biznese.

Përfundimisht, duke marrë parasysh këto shifra, duket se perspektiva e përgjithshme e bizneseve në sektorin e ndërtimit për tre muajt e ardhshëm është shumë optimiste. Një shumicë e tyre presin rritje të qarkullimit, duke treguar për një klimë të favorshme për zhvillimin e tyre në të ardhmen e afërt.


Figura 23: Figure 11 Pritjet e kompanive për qarkullimin e tyre në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



Sipas rezultateve të anketës në sektorin e ndërtimit, rreth 35% e kompanive të anketuara parashikojnë një rritje në çmimet e shërbimeve të tyre për tre muajt e ardhshëm. Kjo mund të interpretohet si një tregues i mundshëm për rritjen e kostove për materiale, punësim, rritjen e kërkesës dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë në çmimet e shërbimeve të ndërtimit. Ky parashikim për rritje të çmimeve, rrjedhimisht kostove reflektohet në çmimet për klientët.

Në anën tjetër, 57% e kompanive kanë deklaruar se presin që çmimet të mbeten të njëjta.

Figura 24: Pritjet e kompanive në sektorin e ndërtimit për tre muajt e ardhshëm sa i përket çmimeve



Rezultatet e prezantuara në figurën e mëposhtme ofrojnë një analizë të rëndësishme në lidhje me shfrytëzimin e kapaciteteve nga kompanitë e sektorit të ndërtimit. Të gjeturat tregojnë se sektori i ndërtimit nuk po shfrytëzon kapacitetin e tij në nivelin optimal. Vetëm një pjesë e vogël, 3.70%, e kompanive raportojnë se shfrytëzojnë maksimalisht kapacitetet e tyre.


Në kategori të tjera, nën 51% të kapaciteteve, shfrytëzojnë rreth 25.93% e kompanive pjesëmarrëse në studim. Kjo tregon që këto kompani kanë ende potencial për të rritur shfrytëzimin e kapaciteteve të tyre.

Në intervalin 51-60% dhe 61-70% të kapaciteteve, 40.74% e kompanive ndahen në mes të këtyre dy kategorive, tregues se këto kompani shfrytëzojnë kapacitetet e tyre në nivel mesatar dhe kanë hapësirë për të rritur efikasitetin në prodhim ose shërbime.

Në intervalin 71-80% dhe 81-90% të kapaciteteve, rreth 30% e kompanive ndodhen, të cilat tregojnë për një nivel më të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve. Kjo është një tregues i rëndësishëm për efikasitetin dhe produktivitetin e tyre, megjithëse ende ka mundësi për të optimizuar operationet për të përfituar më shumë nga kapacitetet ekzistuese.

Në përgjithësi, kjo analizë tregon se sektori i ndërtimit ka nevojë për të punuar në drejtim të një efektiviteti më të madh për të përdorur më mirë kapacitetet ekzistuese dhe për të përmirësuar performancën në nivel të përgjithshëm. Kjo mund të përfshijë përdorimin e teknologjisë dhe metodave të reja duke përfshirë modele qarkore të biznesit dhe materiale të qëndrueshme, si dhe menaxhimin e më të mirë të burimeve dhe proceseve për të arritur një shfrytëzim më të efektshëm të kapaciteteve në sektorin e ndërtimit.

Figura 25: Shfrytëzimi i kapaciteteve nga kompanitë e ndërtimit




Barrierat kryesore me të cilat përballen kompanitë në sektorin e ndërtimit, sipas raportimeve të tyre, janë:

- Mungesa e stafit me shkathtësi adekuate: Ky është një problem i shpeshtë në shumë industri, por në veçanti në sektorin e ndërtimit, ku puna kërkon shkathtësi të veçanta dhe përvojë të specializuar. Raportohet që 62.96% e kompanive përballen me mungesën e personelit me shkathtësi adekuate.
- Vështirësi në gjetjen e fuqisë punëtore: Në vazhdim të problematikës së mungesës së stafit me shkathtësi të nevojshme, rreth 28% e kompanive raportojnë edhe për vështirësi në gjetjen e fuqisë punëtore në përgjithësi. Kjo mund të ketë të bëjë me një shkallë të ulët të interesit për punën në sektorin e ndërtimit, apo edhe me mungesën e trajnimeve ose programeve për të avancuar dhe për të tërhequr fuqinë punëtore të nevojshme drejt këtij sektori.
- Vonesat në pagesa nga konsumatorët: Në një sektor ku shpenzimet janë të mëdha dhe afatet janë të rëndësishme, vonesat në pagesat nga klientët mund të shkaktojnë sfida të mëdha financiare për kompanitë e ndërtimit.

Këto barrierat janë vetëm disa prej sfidave me të cilat përballen kompanitë në sektorin e ndërtimit. Menaxhimi i tyre me sukses mund të kërkojë strategji të përshtatshme të rekrutimit dhe trajnimit të personelit, si dhe të veprimeve të zgjuara financiare për të lehtësuar presionin e vonesave në pagesa.

Figura 26: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të ndërtimit




3.4. Sektori i Tregtise me Shumicë

Në tre mujorin e katërt të vitit 2023 gjithsej janë hapur 718 kompani të sektorit me tregti me shumicë dhe sektorit të tregtisë me pakicë. Ku prej tyre 717 janë kompani të vogla dhe të mesme dhe 1 kompani që kategorizohet në kompani të mëdha. (Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve, TM4 2023).

Gjetjet e paraqitura në figurën e mëposhtme tregojnë se rreth 35% e tregtarëve me shumicë konsiderojnë se gjendja e tyre biznesore gjatë tre muajve të fundit është përmirësuar. Përmirësimi i performancës së biznesit është një shenjë e favorshme për ekonominë dhe mund të reflektojë rritje të kërkesës, përmirësim të strategjive të shitjes, ose rritje të efikasitetit operacional.

Në anën tjetër, rreth 60% e kompanive që operojnë në sektorin e tregtisë me shumicë raportuan se nuk kanë pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe. Kjo mund të tregojë për një stabilitet të aktivitetit të biznesit, por gjithashtu mund të jetë një tregues shqetësues, veçanërisht në një kohë kur priten përmirësime ose rritje.

Figura 27: Vlerësimi i bizneseve rreth gjendjes biznesore në tre muajt e fundit (% e kompanive)




Kompanitë e tregtisë me shumicë shfaqin një nivel të lartë optimizmi për të ardhmen, siç tregojnë rezultatet e anketës. Në fakt, rreth 62% e kompanive në këtë sektor parashikojnë se aktiviteti biznesor do të përmirësohet gjatë tre muajve të ardhshëm. Ky nivel i lartë i optimizmit

sugjeron një besim të fortë në zhvillimin e tregut dhe në mundësitë për rritje të biznesit. Një pjesë tjetër, prej 34%, nuk parashikojnë ndonjë ndryshim të veçantë në gjendjen e tyre.

Optimizmi i lartë në këtë sektor mund të jenë rezultat i faktorëve të tilla si rritja e kërkesës për produktet e tyre, zhvillimi i strategjive të marketingut të suksesshme, ose përparimi në inovacion dhe teknologji.


Figura 28: Pritjet e aktivitetit biznesor në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)



Pritjet e kompanive të këtij sektori janë shumë pozitive dhe sa i përket numrit të porosive tek furnitorët e tyre. Kjo tregon se ky sektor po pret që të rritet kërkesa në vend gjatë tre muajve të ardhshëm, pasi që mbi 60% parashikojnë që të kenë rritje.


Rritja e numrit të porosive te furnitorët është shpeshherë një tregues i pritjeve për rritje të aktivitetit biznesor dhe rritje të kërkesës për produktet dhe shërbimet e tyre. Pra, pritjet pozitive për rritjen e numrit të porosive tek furnitorët tregojnë për një klimë të favorshme për zhvillimin e biznesit në sektorin e tregtisë me shumicë, dhe sugjerojnë për një perspektivë optimiste për rritje të aktivitetit dhe të performancës së tyre në të ardhmen e afërt.

Figura 29: Pritjet e kompanive të sektorit të tregtisë me shumicë për tre muajt e ardhshëm lidhur me porositë tek furnitorët



Në bazë të gjetjeve të prezantuara, duket se shumica e kompanive në këtë sektor presin që çmimet e produkteve të mbeten të pandryshuara gjatë tre muajve të ardhshëm, me mbi 60% të kompanive duke përcaktuar këtë si pritje. Në anën tjetër, rreth 20% e kompanive parashikojnë një rritje të çmimeve të produkteve në tre muajt e ardhshëm.

Figura 30: Pritjet e kompanive të tregtisë me shumicë sa i përket çmimit të produkteve për 3 muajt e ardhshëm




Ndër barrierat me të raportuara të sektorit të tregtisë me shumicë janë mungesa e stafit me shkathtësi adekuate, e raportuar nga 63.51% e kompanive. Raportimi i 63.51% të kompanive për këtë barrierë tregon për një problem të thellë në mospërputhjen e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës. Mungesa e stafit me shkathtësi të nevojshme mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve dhe produktivitetin e kompanive.

Pothuajse gjysma e kompanive, raportojnë për konkurrencë jo të ndershme në treg dhe këtë e klasifikojnë si barrierën e dytë më të përmendur.

Raportimi i 29.73% për mungesën e mjeteve financiare tregon për një tjetër barrierë të rëndësishme. Mungesa e burimeve financiare mund të pengojë investimet në rritjen e biznesit, zhvillimin e produkteve të reja dhe përballimin e shpenzimeve operationale.

Figura 31: Barrierat e raportuara nga kompanitë e sektorit të tregtisë me shumicë




3.5. Sektori i Tregtisë me Pakicë

Rezultatet e prezantuara për sektorin e tregtisë me pakicë ofrojnë një pamje të performancës së biznesit për tre muajt e fundit. Rreth 67% e kompanive të këtij sektori raportojnë se aktiviteti i tyre biznesor ka mbetur i pandryshuar gjatë tre muajve të fundit.


Për përmirësim të aktivitetit biznesore gjatë tre muajve të fundit raportuan 27% e kompanive. Kjo tregon për një rezultat pozitiv për një pjesë të sektorit të tregtisë me pakicë, ku kanë mundur të rrisin performancën e tyre dhe të përfitojnë nga mundësitë e tregut.

Figura 32: Vlerësimi i gjendjes së biznesit nga kompanitë e tregtisë me pakicë në tre muajt e fundit (% e kompanive)




Sektori i tregtisë me pakicë është optimist rreth pritjeve në lidhje me performancën biznesore. Rreth 56% e kompanive në sektorin e tregtisë me pakicë presin që aktiviteti i tyre i biznesit të rritet gjatë tre muajve të ardhshëm. Në anën tjetër, 43% e kompanive presin që aktiviteti i tyre i biznesit të mbetet i pandryshuar. Ndërsa, nga kompanitë e anketuara vetëm 1% kanë deklaruar që pritet të ketë rënie.

Figura 33: Pritjet në lidhje më aktivitetin e biznesit në tre muajt e ardhshëm (% e kompanive)




Në sektorin e tregtisë me pakicë, pritjet lidhur me ndryshimet e çmimeve për tre muajt e ardhshëm tregojnë se rreth 27% e kompanive parashikojnë që çmimet për produktet e tyre të rriten gjatë tre muajve të ardhshëm. Ndërsa, një shumicë prej 67% e kompanive presin që çmimet të mbeten të njëjta.

Figura 34: Pritjet e sektorit të tregtisë me pakicë për çmimit të produkteve për 3 muajt e ardhshëm



Barrierat më të raportuara në sektorin e tregtisë me pakicë janë mungesa e stafit me shkathtësi adekuate, e cila është raportuar nga gjysma e kompanive të pjesëmarrësve në këtë studim. Pasuar nga konkurrenca jo lojale me 45% dhe ekonomia informale me 29%.

Figura 35: barrierat në sektorin e tregtisë me pakicë.



4. Ndikimi i Liberalizimit të Vizave në Sektorin Privat të Kosovës

Hulumtimi jonë për ndikimin e liberalizimit të vizave të kompanitë në Kosovë ka evidentuar disa efekte, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në sfera të tjera. Liberalizimi i vizave ka shkaktuar ndryshime në sektorë të ndryshëm, duke sjell me vete sfida dhe mundësi të reja për kompanitë në vend. Në bazë të rezultateve të analizës, rreth 56% e kompanive kanë raportuar se janë të ndikuar në një formë ose në një tjetër nga liberalizimi i vizave, ndërsa 44% e tyre nuk kanë vënë re ndonjë ndikim të dukshëm (shih figuren 35).

Nga njëra anë, ka pasur sfida të dukshme për disa kompani. Ndër këto sfida mund të përmenden vështirësitë në mbajtjen e punëtorëve (58%), ku liberalizimi i vizave ka rritur lëvizshmërinë e njerzeve/fuqisë punëtore. Në të njëjtën kohë, rritja e kërkesës për rritje të rrogave (46%) është një tjetër sfidë që kompanitë po përballen. Në anën tjetër, liberalizimi i vizave ka hapur edhe mundësi të reja për bizneset në Kosovë. Një ndër aspektet më pozitive është gjetja e partnerëve dhe furnitorëve ndërkombëtarë (18%). Kjo ka mundësuar qasje në tregje të reja dhe rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke sjellë përparim në efikasitetin dhe inovacionin e biznesit. Gjithashtu, është rritur shkëmbimi i eksperiencave dhe know-how me partner ndërkombëtar, e raportuar nga 14% e kompanive.

Është e rëndësishme që politikat dhe strategjitë e biznesit të përshtaten për t'u përballur me këto ndryshime dhe për të përfituar maksimalisht nga mundësitë e ofruara nga liberalizimi i vizave.

Figura 36: Ndikimi i liberalizimit të vizave në sektorin privat të Kosovës





Figura 37: Sfidat dhe mundësitë nga liberalizimi i vizave në Kosovë



Bazuar në analizën e të dhënave me një qasje sektoriale, duket se sektorët e ndërtimit dhe tregtisë me shumicë janë ndër ata më të prekurit nga liberalizimi i vizave në Kosovë sa i përket sfidave. Rreth 68 % e kompanive në sektorin e ndërtimit nga ato që kanë vlerësuar se liberalizimi i vizave ka ndikuar në kompanitë e tyre kanë deklaruar se kanë vështirësi në mbajtjen e punëtorëve dhe se kanë pasur kërkesa për rritje të rrogës nga punëtorët.

Në sektorin e tregtisë me shumicë, situata duket e ngjashme, me një përqindje të konsiderueshme të kompanive (67%) që raportojnë për vështirësi në mbajtjen e punëtorëve dhe kërkesa për rritje të rrogës (43%).

Sa i përket mundësive të reja që kanë ardhur me liberalizimin e vizave, duket se sektori i prodhimit, tregtisë me pakicë dhe shërbimeve kanë përfituar më shumë.


Në sektorin e prodhimit, mbi 20% e kompanive kanë vlerësuar se liberalizimi i vizave ka lehtësuar gjetjen e partnerëve dhe furnitorëve ndërkombëtar. Kjo mundëson qasje në burime të reja dhe tregje të huaja për materiale dhe pajisje, duke ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së tyre. Në të njëjtën kohë, 16% e kompanive prodhuese kanë theksuar se është rritur shkëmbimi i eksperiencave dhe know-how me partnerë ndërkombëtar, duke sjellë inovacion dhe zhvillim të produktit.

Nga sektori i tregtisë me pakicë, rreth 23 % e kompanive kanë vlerësuar se është lehtësuar gjetja e partnereve dhe furnitorëve ndërkombëtar dhe 21% është rritur shkëmbimi i eksperiencave dhe know-how me partner ndërkombëtar, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të tyre të biznesit.

Në sektorin e shërbimeve rreth 16% theksuan se është lehtësuar gjetja e partnereve ndërkombëtar dhe 13% se janë rritur shkëmbimet e eksperiencave dhe know-how me partner ndërkombëtar. Ky faktor ka ndihmuar në zgjerimin e shërbimeve të ofruara dhe në forcimin e lidhjeve me partnerë të huaj. Kjo mund të sjellë inovacion dhe zhvillim të shërbimeve të tyre, duke i bërë ato më konkurrues në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Është e rëndësishme që kompanitë në këtë sektorë të vazhdojnë të përdorin këto mundësi për të zhvilluar bizneset e tyre në një mënyrë të qëndrueshme dhe inovative.

Figura 38: Sfidat dhe mundësitë nga liberalizimi i vizave në Kosovë sipas sektorëve



5. Barrierat e të bërit biznes në Kosovë


Bazuar në rezultatet e studimit të kryer nga Oda Ekonomike e Kosovës, ku janë anketuar rreth 441 kompani, janë identifikuar një sërë barrierash që pengojnë zhvillimin e aktivitetit të kompanive.

Në këtë studim, është identifikuar se një përqindje e lartë e kompanive e cilësojnë mungesën e stafit me shkathtësi adekuate si pengesën kryesore me të cilën përballen gjatë operimit të tyre, me një përqindje prej 58%. Pas kësaj, një përqindje e konsiderueshme e kompanive raportojnë për konkurrencë jolojale (37%), mungesën e mjeteve financiare (28%), dhe vështirësi në gjetjen e fuqisë punëtore (28%) si barriera të rëndësishme që pengojnë zhvillimin e tyre.

Në vazhdim, kompanitë identifikuan edhe disa barriera të tjera si kostoja e lartë e energjisë elektrike (28%), konsumatorët që nuk paguajnë në kohë (27%), kamata e lartë (21%), ekonomia informale (21%), dhe mungesa e kapaciteteve teknike (17%). Për më shumë barriera shih figurën 38.

Këto rezultate tregojnë për barrierat dhe sfidat me të cilat ballafaqohen kompanitë në Kosovë në përpjekjen e tyre për të zhvilluar dhe rritur biznesin. Identifikimi i këtyre sfidave është kritik për të përcaktuar politikat dhe strategjitë e duhura për të adresuar këto pengesa dhe për të përmirësuar klimën e biznesit në vend.

Figura 39: Barrierat e të bërit biznes në Kosovë



5.1. Masat për të adresuar barrierat e identifikuara

Identifikimi i barrierave kryesore që pengojnë zhvillimin e kompanive është një hap i rëndësishëm për të ndërmarrë masa efektive për të adresuar këto sfida. Bazuar në rezultatet e studimit, disa masa që mund të merren për të adresuar këto pengesa janë:

- Mbështetje në zhvillimin e fuqisë punëtore: Investimi në trajnim dhe zhvillimin e punonjësve për të adresuar mungesën e stafit me shkathtësi adekuate. Kjo mund të përfshijë ofrimin e trajnimeve të specializuara dhe programeve të zhvillimit profesional.
- Rritja e transparencës dhe zbatimi i ligjit: Veprime ligjore dhe institucionale për të luftuar konkurrencën jolojale dhe ekonominë informale. Kjo përfshin përmirësimin e sistemit ligjor dhe zbatimin e rregullave të tregut për të garantuar një konkurrencë të drejtë dhe të barabartë.
- Zhvillimi i mekanizmave financiare për mbështetjen e kompanive: Krijimi i programeve të subvencioneve, kredive dhe mbështetjes financiare për të adresuar mungesën e mjeteve financiare. Kjo mund të përfshijë fonde të dedikuara për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe inicativa për të lehtësuar qasjen në financa.

- Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe sektorin publik: Partneritetet me universitetet dhe institucionet arsimore për të siguruar trajnimin dhe aftësimin e nevojshëm për fuqinë punëtore. Gjithashtu, bashkëpunimi me qeverinë dhe institucionet publike për të adresuar problemet strukturore që prekin zhvillimin e bizneseve.

Këto masa janë vetëm disa nga shumë mundësitë për të adresuar barrierat e identifikuara dhe për të përmirësuar klimën e biznesit në Kosovë. Është e rëndësishme që qeveria, odat ekonomike, bizneset dhe aktorët e tjerë të bashkëpunojnë për të zbatuar këto masa në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

6. Konkluzione dhe Rekomandime

Bazuar në përmbledhjen e studimit "Klima e Biznesit në Kosovë" për tremujorin e katërt të vitit 2023, konkluzionet për situatën e biznesit në vend janë:

Gjendja e përgjithshme e biznesit është e favorshme, Indeksi i klimës së biznesit ka treguar një rritje të konsiderueshme, me një shkallë rritjeje prej 23 pikësh në krahasim me tremujorin paraprak. Kompanitë raportojnë vlerësime pozitive për gjendjen e tyre aktuale dhe kanë pritje të përmirësimit të situatës së biznesit në muajt e ardhshëm, sidomos për shkak të sezonit të verës. Gjithashtu, pritjet për punësim për tre muajt e ardhshëm janë pozitive.

Sa i përket gjendjes aktuale, evidentohet se nuk ka shumë dallime në mes të sektorëve. Megjithatë, sektori i tregtisë me shumicë ka raportuar të ketë një performancë pak më të mirë në krahasim me sektorët e tjerë. Pritjet për punësim për tre muajt e ardhshëm, më optimiste i ka sektori i ndërtimit në krahasim me sektorët e tjerë. Konkretisht, 42% e kompanive të anketuara në këtë sektor raportuan që presin të rrisin numrin e punëtorëve të tyre, ndjekur nga sektori i shërbimeve me 35% dhe sektori i prodhimit me 34%. Ndërsa, sa i përket pritjeve për 6 muajt e ardhshëm, sektori i prodhimit dhe sektori i shërbimeve kanë pasur pritjet më optimiste asnjë biznes nuk ka raportuar se do të ketë një zhvillim të pafavorshëm.

Rrjedhimisht, mund të themi se gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 bizneset raportuan një gjendje të favorshme në aspektin e aktivitetit ekonomik, e cila përputhet me një parashikim optimist për periudhën e ardhshme.

Në kuadër të këtij studimi është vlerësuar dhe ndikimi i liberalizimit të vizave te kompanitë tona. Liberalizimi i vizave ka sjell me vete sfida dhe mundësi të reja për kompanitë. Në bazë të rezultateve të analizës, rreth 56% e kompanive kanë raportuar se janë të ndikuar në një formë ose në një tjetër nga liberalizimi i vizave, ndërsa 44% e tyre nuk kanë vënë re ndonjë ndikim të dukshëm. Nga njëra anë, ka pasur sfida të dukshme për disa kompani në mbajtjen e fuqisë punëtore (58%) dhe rritjes së kërkesës për rritje të rrogave (46%). Ndërsa, në anën tjetër, liberalizimi i vizave ka hapur edhe mundësi të reja për bizneset në Kosovë. Një ndër aspektet më pozitive është gjetja e partnerëve dhe furnitorëve ndërkombëtarë (18%) dhe shkëmbimi i eksperiencave dhe know-how me partner ndërkombëtar (14%). Bazuar në analizën e të dhënave me një qasje sektoriale, duket se sektorët e ndërtimit dhe tregtisë me shumicë janë ndër ata më të prekurit nga liberalizimi i vizave në Kosovë sa i përket sfidave. Sa i përket mundësive të reja që kanë ardhur me liberalizimin e vizave, duket se sektori i prodhimit, tregtisë me pakicë dhe shërbimeve kanë përfituar më shumë.

Pavarësisht vlerësimeve pozitive të kompanive për gjendjen e përgjithshëm biznesore, kompanitë perballen dhe me sfida të mëdha. Mungesa e stafit me shkathtësi adekuate, konkurrenca jolojale dhe mungesa e mjeteve financiare janë disa nga problemet kryesore që ndikojnë në zhvillimin e tyre. Në bazë të analizës sektoriale, barriera më e raportuar nga të gjithë sektorët është mungesa e stafit me shkathtësi të adekuate (70%). Barriera e dytë me e raportuar në sektorin e prodhimit është kostoja e energjisë elektrike (55%), në sektorin e

shërbimeve konkurrenca jolojale (36%), në sektorin e ndërtimit, vështirësi në gjetjen e fuqisë punëtore (28%) dhe në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë konkurrenca jolojale.

Në bazë të analizës, rekomandimet që dalin nga ky raport janë si në vijim: Mbështetje në zhvillimin e fuqisë punëtore; Rritje e transparencës dhe zbatimi i ligjit; Zhvillimi i mekanizmave financiare për mbështetjen e kompanive; dhe Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe sektorin publik.

Referenca

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (a.d.). *Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve, TM4 2023*.
- OECD. (2024). *Business confidence index (BCI)*. <https://doi.org/10.1787/3092dc4f-en>.
- Uzunidis, D. (2013). Business Climate and Entrepreneurialism, *Encyclopedia of Creativity, Invention, Innovation and Entrepreneurship*. ISBN : 978-1-4614-3857-1.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara ©2024
Oda Ekonomike e Kosovës